ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit nr. **104/12400-26-5644-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Angazhimi i katër (4) konsulentëve individual për nevoja të DSS – Qendrën e thirrjeve CATI**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

_____ *NJOMZA NEBIHI* _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

___*Rr. Hamdi Grajqevci,* _*FUSHËKOSOVË*_____
(Adresa)
_____*FUSHËKOSOVË* _____ _____
(Vendi) *(Kodi postar)*
_____*+383/49 485 393* _____ _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____*NJOMZA NEBIHI* _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____*ekrem.nebihi@uni-pr.edu* _____
(Adresa elektronike)

_____*05.11.2026* _____ _____
**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

-Njoftimi per kontrate 13.07.2026
-Afatit per dorezimin e Ofertave 03.08.2026 13:30
-Kriteri per dhenje te Kontrates; ekonomikisht më i favorshëm
-B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 03.08.2026
- B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit 01.09.2026
-B58 Njoftim per vendimin e AK-se per **Anulim Aktivitetit 19.10.2026**
-**Kerkese per Rishqyrtim date; 23.10.2026**
- **B10 Vendimi per Anulim Aktivitetit 23.10.2026**
- Vendim mbi Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim 26.10.2026 12:28

4. Procesi i Hapjes së tenderëve,
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Ne mbështetje te nenit 108A te LPP-se ne me date 23.10.2026 kemi kërkuar nga AK te beje Rishqyrtim te Vendimit te dates 19.10.2026 per Anulim te aktivitetit te Prokurimit, mirpo kjo kerkese eshte refuzuar me date 26.10.2026.
AK ka konsideruar se pretendimet ankimore nuk jan te bazuara.

Bashkangjitur ;Kërkesën për ri-shqyrtim, Vendimin mbi kerkesen per Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1- Qëllimi,
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit LPP-se
Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit *- RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)*
Neni-in 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pakenaqur me vendimin e datës 26.10.2026 mbi refuzimin e kërkesës tone per rishqyrtim nga AK- **AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS** *ne lidhje me aktivitetin e prokurimit:* **"Angazhimi i katër (4) konsulentëve individual për nevoja të DSS – Qendrën e thirrjeve CATI me nr.Prokurimi# 104/12400-26-5644-2-2-1** *ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, prane OSHP-se ushtrojmë këtë:*

ANKESË

Me date 23.10.2026 kemi kërkuar nga AK te beje Rishqyrtim te Vendimit ***B58 njoftimit mbi vendimin e AK****-se dates 19.10.2026, mirpo kjo kerkese eshte refuzuar ku AK ka refuzuar kërkesën time për rishqyrtim duke mos e shqyrtuar në substancë kërkesën time sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).*

Ne kete vendim mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim vërehët se në faqen 1, dispozitivi shënon datën e saktë të kërkesës, 23.10.2026, ndërsa arsyetimi thotë se ajo është pranuar më 14.07.2026, para hapjes së ofertave dhe para anulimit. Në faqen 2, AK-ja thotë se kërkesa nuk përmban pretendime konkrete dhe shtjellon kriteret e dhënies së kontratës.

Në kërkesen time, tek pretendimi 1. ne kemi kundërshtuar anulimin sipas nenit 62 të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores, si dhe tek pretendimi nr. 2 kemi ngre një pretendim të veçantë për komunikimet lidhur me ankesën nr.OSHP 527/26 te aktivitetit tjeter te prokurimit me te njejtin Autoritet. Në këtë pretendim kam pretenduar se AK-ja qellimisht më kërkoi ta tërhiqja ankesën nr.OSHP 527/26 për procedurën e mëparshme nr. 104/12400-26-3435-2-2-1 duke iu referuar propozimit tim për kontratë në procedurën aktuale, dhe pas terheqjes se ankeses AK merr vendim per Anulim te ketij Aktivitetit per te cilin veq se isha propozuar per kontrate dhe me ishiun kerkuar dokumentet e Pershtatshmerise (vertetimi nga ATK dhe Gjykata).

Vlene te theksohet se AK ka bërë Publikimin e parakohshëm të njoftimit për anulim

AK-ja publikoi B58 më 19.10.2026, ndërsa B10 më 23.10.2026, kur afati pesëditor për kërkesë për rishqyrtim ende nuk kishte skaduar. Kërkesën për rishqyrtim e dorëzova më 23.10.2026 dhe AK-ja vendosi për të më 26.10.2026. Sipas nenit 43.2 të Rregullores për Prokurimin Publik, Vendimi për anulim publikohet pas kalimit të afateve për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave. Kërkoj që OSHP-ja të verifikojë datën dhe orën e publikimit të B10 në e-Prokurim dhe të konstatojë shkeljen procedurale.

Pretendimet tona lidhur me këtë vendim të AK-se ishin si me poshtë;

Pretendimi 1.

Arsyetimi i AK-se ne B58Njoftimin mbi vendimin date 19.10.2026 ishte;

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: **Angazhimi i katër (4) konsulentëve individual për nevoja të DSS – Qendrën e thirrjeve CATI**

Nr. i Prokurimit:	**104/12400-26-5644-2-2-1**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Autoritetit Kontraktues ASK **nuk shpërblen** me kontratë asnjë OE-Person Fizik por vendos që të anulojë proceduren e prokurimit bazuar në piken 1. 1 të paragrafit 1 të nenit 62 të LPP-së.

Komisioni i vlerësimit, i caktuar për zhvillimin dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit me titullin "Angazhimi i katër (4) konsulentëve individualë për nevojat e Departamentit të Statistikave Sociale (DSS) – Qendra e Thirrjeve CATI", me numër të prokurimit 104/12400-26-5644-2-2-1, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, ka përzgjedhur katër (4) kandidatë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.
Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, Komisioni është njoftuar lidhur me kërkesën e njësisë kërkuese për anulimin e procedurës së prokurimit, për shkak të ndryshimit të nevojave aktuale të Departamentit të Statistikave Sociale (DSS).
Në këtë drejtim, njësia kërkuese, përmes kërkesës, të dates 01.10.2026, ka kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit, duke arsyetuar se nevojat aktuale të departamentit kanë ndryshuar, përkatesisht se angazhimi I katër konsulenteve individual në kete faz, nuk paraqet me të njejten domosdoshmeri si në kohen kur është inicuar procedura.
Po ashtu, në bazë të Vendimit të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), me numër 01/649-2026, të datës 02.10.2026, është vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit, ndërsa mjetët financiare të planifikuara për këtë aktivitet do te rialokohën për financimin e nje projekti tjeter institucional me prioritet më te lart (projekti I Regjistrimit të Bujqësisë) çka ka bër qe mjetet e nevojshe për vazhdimin e aktivitetit të mos jenë më në dispozicion.
Komisioni konstaton se procesi i vlerësimit është përfunduar për katër (4) LOT-et, ndërsa procedura e prokurimit nuk ka vazhduar tutje për shkak të ndryshimit të nevojave të njësisë kërkuese dhe vendimit përkatës për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Data: 19.10.2026

Letër standarde për tenderuesin e Pasukseshem [3]

[19.10.2026]

AK ASK, Prishtine

Arbnorë Ramadani, Elheme Pllana, Emel Reçica, Nexhmedin Osmani, Mandalena Jonuzaj, Fitore Demaj Hamiti, Albina Neziri, Shyhrete Bërbatovci, Marigona Matoshi, Njomza Nebihi, Ardita Shala

Nr. i Prokurimit:	104/12400-26-5644-2-2-1

Titulli: : Angazhimi i katër (4) konsulentëve individual për nevoja të DSS – Qendrën e thirrjeve CATI

Lot 1 - Lot 2 - Lot 3 – Lot 4.

I/e nderuar(a) *znj. Arbnorë Ramadani, Elheme Pllana, Emel Reçica, Nexhmedin Osmani, Mandalena Jonuzaj, Fitore Demaj Hamiti, Albina Neziri, Shyhrete Bërbatovci, Marigona Matoshi, Njomza Nebihi, Ardita Shala*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi i juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit.
Me keqardhje ju njoftojmë se Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, Komisioni është njoftuar lidhur me kërkesën e njësis kërkuese me daten 01.10.2026, përmes të ciles ka kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit, duke arsyetuar se nevojat aktuale të departamentit kanë ndryshuar, përkatesisht se angazhimi i katër konsulenteve individual në kete faz, nuk paraqet me të njejten domosdoshmeri si në kohen kur është inicuar procedura.
Po ashtu, në bazë të Vendimit të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), me numër 01/649-2026, të datës 02.10.2026, është vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit, ndërsa mjetët financiare të planifikuara për këtë aktivitet do te rialokohën për financimin e nje projekti tjeter institucional me prioritet më te lart (projekti I Regjistrimit të Bujqësisë) çka ka bër qe mjetet e nevojshe për vazhdimin e aktivitetit të mos jenë më në dispozicion.

Andaj bazuar në faktet e cekura me larte dhe në piken 1. 1 të paragrafit 1 të nenit 62 të LPP-së, Anulohet ky aktivitet i prokurimit.

Me respekt,
Njesia e Prokurimit ASK


---


[3] Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

Te nderuar, ju si AK ne kete arsyetim sipas dokumentit B58 deshmoni se komisioni Vleresues ka përfunduar vlerësimin për katër LOT-et dhe ka përzgjedhur katër kandidatë sipas kritereve të dokumentacionit të prokurimit. Pas përzgjedhjes sime - rekomandimit nga ana e Komisionit vleresues, ju si Autoritet Kontraktues më keni kërkuar me letër standarde dokumentet e përshtatshmërisë, përkatësisht certifikatën penale dhe vërtetimin e ATK-së. Këto dokumente i kam dorëzuar sipas kërkesës me date 01.09.2026 . **(Letra dhe dëshmitë e dorëzimit shih me poshte).**









Megjithatë, më date 19.10.2026 Ju si AK keni njoftuar anulimin e ketij aktiviteti duke ju referuar NEN-i 62 pika 1.1 të paragrafit 1 te LPP-së, e poashtu me arsyetimin duke iu referuar kërkesës së DSS-së të datës 01.10.2026 dhe vendimit të ZKA-së nr. 01/649-2026, të datës 02.10.2026. Anulimi i ketij aktiviteti nuk eshte ne perputhje me nenin 62 te LPP-se , dhe arsyetimi juaj duke perdorur nenin 62 eshte joprofesional dhe i paarsyeshem, pasi qe NEN-i 62 pika 1.1 thote:

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dhe ne kete rast nuk kemi te bëjmë me asnjeren nga arsyet e paraqitura ne NEN-in 62 pika 1,1.1 sepse; nuk ka ndodhur apo nuk pritet te ndodhe asnje shkelje ligjore qe te mund ta arsyetonte anulimin e ketij aktiviteti prokurimit.

Poashtu edhe NENI 62 pika 2 paragrafi 2.1 dhe 2.2 nuk parashohin mundesine e anulimit te ketij Aktiviteti ku thuhet;

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Poashtu ky Vendim per Anulim te aktivitetit te prokurimit bie ndesh edhe me **NEN-in 43.1 dhe 43.5 i RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) ,** *pasi qe ky nen sqaron ne menyre te qarte se cilat nga arsyet mund te shpiejn ne anulimin e aktivitetit te prokurimit pas hapjes se Ofertave.*

Arsyetimi juaj i paraqitur se ndryshimi i nevojave, zvogëlimi i domosdoshmërisë së angazhimit të konsulentëve dhe rialokimi i mjeteve për projektin e Regjistrimit të Bujqësisë, nuk ka baze ligjore per anulim te aktivitetit te prokurimit.

Pretendimi 2.

Ju, si AK, më keni kërkuar të heq dorë nga ankesa në OSHP nr. 527/26, e datës 24.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 104/12400-26-3435-2-2-1, duke u arsyetuar se jam propozuar për kontratë në procedurën e tanishme nr. 104/12400-26-5644-2-2-1. Këtë fakt e keni deklaruar edhe në përgjigjen ndaj ekspertit shqyrtues për ankesën në OSHP nr. 527/26. Megjithatë, pasi keni kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë dhe unë i kam dorëzuar ato, e keni anuluar tërësisht këtë aktivitet.
Kjo rrjedhë veprimesh ngre dyshim të arsyeshëm se ju, si AK, e keni përdorur qëllimisht përzgjedhjen time për kontratë për të më nxitur të tërhiqem nga ankesa në OSHP nr. 527/26, ndërsa më pas e keni anuluar procedurën e prokurimit, duke cenuar mundësinë time për mbrojtje efektive juridike.
Pretendoj se ky veprim përbën sjellje mashtruese dhe kërkoj që qëllimshmëria të shqyrtohet mbi bazën e komunikimeve dhe kronologjisë së dokumentuar.
Pas gjitha ketyre fakteve te ofruara shpresojm dhe besojm se AK do ta shqyrtoj me kujdes kerkesen tone dhe do ta aprovoj si te bazuar duke marre:
_----------

Kjo menyre e refuzimit te kerkeses tone per Rishqyrtim pa e arsyetuar vendimin per Refuzim per secilin pretendim tone eshte ne kundershtim te plote me ***Neni-in 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.***

Në këtë fazë, AK-ja mund ta anulonte aktivitetin vetëm nëse plotësoheshin kushtet ligjore për anulim sipas NEN-it 62 LPP-se.
Vendimi përmend ndryshimin e nevojave dhe rialokimin e mjeteve, por nuk shpjegon si i plotësojnë këto rrethana kushtet e nenit 62, nënparagrafit 1.1.

Për më tepër, sipas datës së deklaruar të publikimit, AK-ja publikoi B10 më 23.10.2026, para skadimit të afatit për rishqyrtim. Po atë ditë dorëzova kërkesën për rishqyrtim, për të cilën AK-ja vendosi më 26.10.2026. B10 është publikuar para kohe, në kundërshtim me nenin 43.2 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Pas gjithe asaj qe u tha me lart, ne kërkojmë nga Paneli shqyrtues i OSHP-se qe bazuar ne shpjegimet dhe dëshmitë e dhëna me lart te:

1. ***Aprovoi*** *ne teresi ankesën tone si te bazuar, duke konstatuar shkeljet ligjore te AK-se per Anulim te Aktivitetit te Prokurimit.*
2. ***Te anuloje*** *Vendimin e dates 19.10.2026, dhe Lenda te kthehet ne Rivleresim.*

Me respekt;
Njomza Nebihi ***date;05.11.2026***

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

nevojitet nje ekspertize financiare dhe profesionale per te konstatuar sakt demet e shkaktuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
c) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se
d) Kerkesen per Rishqyrtim date 23.10.2026
e) Vendimin e AK-se date 19.10.2026